



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenin 22 paragrafi _ dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikë së Maqedonisë, numër 12/2019) dhe nenin 36 paragrafi 1 dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), Komisioni shtetëror duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtrues i panjohur, në vazhdimin e senacëa së 46-të të mbajtur me datë 19.02.2021, morri

VENDIM

Procedura e ngritur pas denoncimit për korrupsion me numër 12-4472/1 me datë 26.09.2019 nga parashtrues i panjohur – banor i komunës së **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka bazë për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën 12-44672 nga viti 2019 e formuar në bazë të denoncimit nr. 12-4472/1 me datë 26.09.2019.

Lënda me numër 09-4472/1 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin – në formë të depersonalizuar të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej pesë ditë nga dita e marrjes së vendimit.

SQARIM

Lënda me numër 09-4472 nga viti 2019 e formuar në bazë të denoncimit nr. 12-4472/1 me datë 26.09.2019, dorëzuar nga parashtrues i panjohur – banor i komunës së

Me akuzat në denoncim flitet për dyshime të shprehura për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit nga ana e personave zyrtar në komunën e në procedurën për përcaktim të statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje, gjegjësisht edhe në procedurën për largimin e objektit të ndërtuar pa leje – garazhë/autoservis të investitorit person fizik nga

Gjatë veprimit në lëndën e denoncuar të rastit, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit duke u nisur nga akuzat e parashtruesit, me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktike bëri edhe kontrollime adekuate administrative në lidhje me besueshmërinë e tyre dhe bazën në mënyrë që të ndërmer veprime procesive – dorëzoi kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve – me shtojcë dokumentacion, nga komuna – Kryetari i komunës së, Njësia për revizion të brendshëm dhe Sektori për mbikqyrje investitive – Inspektorati, Inspektoratit të ndërtimtarisë pranë komunës në lidhje me lëndën dhe procedurën në të cilën është miratuar vendimi i plotfuqishëm nr. për largim të objektit të ndërtuar pa leje garazhë/autoservis nga ana e ndërtuesit, në lidhje me lëndën dhe procedurën për përcaktim të statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje – shtëpi individuale për banim në teritorin e komunës së personit të njëjtë si parashtrues i kërkesës në procedurën, duke përfshirë edhe për ndërtimin e garazhlës plotësuese (shkallë, derë etj), kurse në aspekt të çështjes se vallë bëhet fjalë për objekt të ndërtuar pa leje, gjegjësisht

uzurpim eventual – zaptim pa leje dhe ndertim pa leje ne tokē ndertimore ne pronēsi tē Republikē sē Maqedonisē sē Veriut.

Rrjedhimisht, nga tē gjitha organet e thirrura - shrēbime, deri tek Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit janē dorēzuar pēegjigje me shkrim me shtojcē dokumentaion – fotografi dhe akte nga veprimet tē cilēt janē ndērmarrē ne lidhje me rastin e lēndēs ne periudhēn prej viteve 2019 – 2020.

Qartē shihet nga pērgjigjet e dorēzuara dhe nga shkrimet, Komisioni shtetēror konstaton se me datē 29.10.2019 nga ana e Inspektoartit tē autorizuar pranē komunēs janē bērē inspektime tē jashtēzakonshme tē shkallēve tē shtēpisē familjare dhe tē derēs, pērmendur nga parashtruesi, e cila gjendet ndērmjet parcelēs kadastrale ne KK pērveç tē konstatuarēs pēr lēndēn nga inspektimi ne procesverbalin nga i njējti gjenden edhe konstatime pēr shtēpinē familjare tē investitorit e cila ēshtē ndērtuar ne vitin 2010 ne parcelēn e cila ēshtē ne pronēsi tē personit juridik – si objekt i ndērtuar pa leje, ne raport tē llogaritur nga viti 2011 deri ne vitin, pērshkak tē shfrytēzimit tē mjeteve juridike ēshtē ngritur procedurē pēr pērcaktim tē statusit tē objektit tē ndērtuar pa leje.

Kjo procedurē ēshtē e plotfuqishme dhe e pērfunduar ne muajin mars tē vitit dhe me miratimin e vendimit janē pērfshirē edhe shkallēt e diskutueshme, kurse ne lidhje me derēn e diskutueshme me inspektimin ēshtē vērtetuar se ajo nuk ekzistonē ne vendngjarje.

Ne procedurēn pēr pērcaktim tē statusit tē objektit tē ndērtuar pa leje lēndē e veprimit ēshtē pērfshirē edhe objekt i ndērtuar pa leje – objekt afarist – garazhē/servis, e investitorit tē njējtē, mirēpo, ne lidhje me kētē objekt duke pasē parasyshē se nuk i plotēson kushtet e kērkuara me ligj kērkesa e parashtruesit ēshtē rrefuzuar.

Lidhur me tokēn ne pronēsi tē RMV me tē cilēn ka tē bējē njē pjesē e akuzave nga denoncimi dorēzuar deri tek Komisioni shtetēror, nga shkrimet ēshtē konstatuar se sipas Planin gjeneral urbanistik tē komunēs, e njējta deri ne vitin 2017 ēshtē llogaritur si "sipērfaqe e gjelbēr", kur i ēshtē ndruar statusi ne banim A1 ne shtēpi familjare me kultura.

Ne lidhje me hapsirēn afariste tē ndērtuar pa leje tē ndērtuesit ne rastin e lēndēs deri tek Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit janē dorēzuar shkrime - akte nga komuna ne procedurēn ne tē cilēn ēshtē miratuar Vendimi me tē cilēn investitorit i urdhērohet ta largon objektin, nga tē cilat ēshtē konstatuar se me atē 31.07.2019 Sektori pēr mbikqyrje investitive dērozoi deri tek Kryetari i komunēs, propozim pēr ekzekutim tē detyrueshēm administrativ tē akteve tē plotfuqishme ekzekutive tē cilēt kan tē bējnē me njēmbēdhjet objekte ndēr tē cilēt edhe objekt i diskutueshēm – hapsira afariste/servis, si dhe shkrimet e lēndēs – pērshkak tē ankesēs sē dorēzuar nga ndērtuesi e plotē gjendet tek Komisioni shtetēror pēr vendimmarrje tē shkallēs sē dytē nga fusha e mbikqyrjes investitive dhe procedurēs pēr kundērvajtje, dhe edhpse e dorēzuar ne muajin maj tē viti 2019 e njējta deri me 18.02.2020 nuk ēshtē e zgjidhur edhe pērska j Urgjencēs sē dorēzuar.

Nga tē gjitha shkrimet dhe dokumentacionet e dorēzuara pēr kētē rast tē denoncuar, Komisioni shtetēror konstaton se ne rastin e lēndēs kanē vepruar organe kompetente dhe shrēbime nga komuna, nga mē shumē aspekte, kurse ne pjesēn e procedurēs qē ka tē bējē me objektin e ndērtuar pa leje – hapsirē afariste/servis, veprimi i komunēs ēshtē ne fazēn e dorēzimit tē propozimit pēr ekzekutim tē detyrueshēm administrativ pēr largim tē tē njējtit, qē don tē thotē se ai ende nuk ēshtē larguar nga ana e komunēs m gjē qē ēshtē shumē e shpesh tē

në RMV dhe që më së shpeshti ka të bëjë me shkaqe finansiare lidhur me shpenzimet për ekzekutim të cilat i paguan komuna, dhe pastaj t'i kompenzon ndërtuesi.

Në bazë të të gjitha rrethanave për rastin e denoncuar të lëndës dhe pas shqyrtimit të plotë të shkrimeve – Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vlerëson se akuzat në denoncim nuk flasin për korrupsion – keqpërdorim të funksionit, autorizimit publik, detyrës zyrtare ose pozitës për realizimin e interesave, të drejtpërdrejta ose nëpërmjet ndërmjetësuesit, për vete ose për dikë tjetër nga ana e personave zyrtar të cilët veprojnë në rastin konkret, i cili mund të ngritet në bazë të dyshimeve për kryerje të veprave penale nga Kapitulli i tridhjetë – vepra penale kundër detyrës zyrtare nga Kodi penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Duke pasë parasyshë të shënuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dipozitive të këtij vendimi.

Ky vendim është i prerë dhe kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

Është vendosur me datë 19 shkurt të viti 2021 me numër/.....

KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT
Zëvendës-kryetarë: Shemshi Sallai

Pas përfundimit të KSHPK
Përpunoi: H. M., këshilltarë
Miratoi: m-r Shemshi Sallai, anëtar i KSHPK
Dorëzuar deri tek: Arkiav